



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E DRAGASHIT  
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 24.06.2024

### **PROCESVERBAL**

**Takimi I (i parë) Publik me qytetarë për punën gjashtëmuajore të  
Kryetarit dhe ekzekutivit lokal  
I mbajtur më 18.06.2024 (e martë)  
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Njoftimi për këtë Takim Publik është publikuar më 28.05.2024:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/05/Takimi-I-publik-1-1.pdf>

Bosnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/05/Takimi-I-publik-2.pdf>

Në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/CHK2UpfnMePM76nA/>

Bosnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/Atf8DJfbHB1NA8g8/>

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë gjithsej 30 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 4
2. Meshkuj: 26

**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash**

02 Nr. Br. 060/01-11967/24  
24.06.2024  
Dragash - Dragash

REPUBLICA E BOLIVIA  
REPUBLICA BOLIVIANA  
Bolivia - D. de Bolivia  
Bolivia - Bolivia

1964  
Bolivia - Bolivia

## **Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini.**

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, ju falënderoj që keni gjetur kohë për të marrë pjesë në Takimin e Parë Publik të organizuar me qytetarë. Siç e dini, ne si Komunë jemi të obliguar ligjërisht që brenda një viti t'i mbajmë së paku dy takime publike me qytetarë, ku në pikë të përgjithshme mund të raportojmë për ecurinë e punës së organeve të Ekzekutivit lokal dhe kryetarit të Komunës.

Andaj, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes një pasqyrë të shkurtër për ecurinë e punëve dhe angazhimet që ka pasur Komuna e Dragashit gjatë këtij gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024. Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mire brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që shumicën e punëve dhe projekteve t'i realizojmë në bazë të Planit të paraparë të Punës.

Puna e Kryetarit, përkatesisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

### **Syntezat e politikave të qeverisje janë:**

- Qeverisje të mirë, të përgjithshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;
- Qeverisje me plane dhe shikim kah e ardhmja;
- Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse të jenë problemet;
- Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;
- Qeverisje që përballet me guxim dhe kryen pune me dinamike të lartë e nuk vonohet;
- Qeverisje që vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetareve tanë të të gjitha shtresave;
- Qeverisje ndërtuese që promovon përfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin e Komunës, bashkësinë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;
- Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshinë në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;
- Qeverisje për të gjithë pa dallim.

Do t'i lexoj edhe vendimet që vendimet që i ka marrë kryetari i Komunës, 88 vendime të ndryshme:

- Vendime për shpallje të tenderëve 48;
- Vendime për caktimin e menaxherëve të kontratave 25;

- Vendime për komisione të pranimit teknik 11;
- Vendime për punë shtesë 1;
- Vendime për caktimin e zyrtarit autorizues 10;
- Vendime për formimin e komisioneve për shqyrtimin e përbushjes së obligimeve 2;
- Total vendime 185.

Memorandume, marrëveshje apo kontrata:

- Memorandum bashkëpunimi në mes të MZhR-së, MAPL-së dhe Komunës së Dragashit për transferimin e rojeve të pyllit 1;
- Memorandum mirëkuptimi në mes të MASHTI dhe Komunës së Dragashit për blerjen e pajisjeve në shkoll 1;
- Memorandum mirëkuptimi me organizata ndërkombëtare humanitare për përkrahjen dhe integrimin e grave në zonat rurale të Komunës 1;
- Memorandum mirëkuptimi për financimin e projekteve infrastrukturore me MMPhi në vlerë 350 mijë euro 1;
- Marrëveshje me “Ekoregionin” për largimin e mbeturinave, pastrimin e shesheve dhe trotuareve 1;
- Marrëveshje bashkëpunimi me “Hidroregionin Jugor” për ofrimin e shërbimeve specifike, deblokimin e kanalizimeve dhe puseve 1;
- Marrëveshje për realizimin e skemës ‘praktikë në punë’ me UNDP-në 1;
- Marrëveshje për mbështeteje të projektit “Renovimi i rrugëve lokale të asfaltuara në regjionin e Gorës” 1;
- Marrëveshje për renovimin e rrugëve në regjionin e Opojës 1;
- Marrëveshje për mbështetje financiare të projektit “Blerja e një traktori për pastrimin e borës 1;
- Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Dragashit dhe Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave 1;
- Kontratë për mbështetje financiare ndërmjet Komunës së Dragashit dhe ShKA “Bresana” për manifestime kulturore 1;

Gjithashtu, kryetari i ka pasur edhe 17 kërkesa. Të gjitha lëndët e përpunuara nga Zyra e Kryetarit për periudhën janar-qershor, janë 220, pa i përfshirë kërkesat për ndihmë financiare të cilat janë ende të pashqyrtuara, diku afér 400 kërkesa. Unë po i përmendi tash disa aktivitete të rëndësishme që i kemi pas ne si Komunë:

- Edhe përgjatë këtij viti kemi vazhduar bashkëpunimin me institucionet e Republikës së Turqisë në Kosovë, ku kemi realizuar një sërë kërkesash tona, siç është Ultrazëri modern me tri sonda për nevojat e gjinekologes në QKMF, ndërtimi i Këndit të lojëra për fëmijë në oborrin e Shkollës “Fetah Sylejmani” në Dragash etj.;
- Në fushën e Kulturës dhe Sportit kemi shapllur Thirrje publike për financimin e OJQ-ve lokale për organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe sportive të cilat janë organizuar me rastin e shënimit të datave të rëndësishme historike;
- Si Qeverisje lokale kemi filluar hartimin e politikave për fillimin e procedurave të një planifikimi më të mirë urban në qytezën e Dragashit, ku fillimisht do të fokusohemi në rregullimin e infrastrukturës ndërtimore te Tregu i Gjelbër dhe pastaj, në bazë të mundësive ligjore do të angazhohemi edhe për investime të tjera në zona të ndryshme të qytezës;
- Në fillim të këtij viti, me Ambasadën e Japonisë kemi nënshkruar një Marrëveshje për financimin (71 mijë euro) e ndërtimit të objektit të tipit të mbyllur për grumbullimin e mbeturinave në hyrje të fshatit Restelicë. Ky projekt është në realizim e sipër dhe pritet të përfitojnë 5 mijë banorë nga ky investim që do të ndikojnë drejpërdrejt në ruajtjen e ambienit;
- Komuna e Dragashit është në mesin e 11 komunave në Kosovë që ka fituar Grantin e Performancës (afér 362 mijë euro) për vitin 2022. Përmes këtij Granti ne syojmë të realizojmë disa projekte me rëndësi ne Komunën tonë;
- Me organizatën ASB kemi nënshkruar një Marrëveshje bashkëpunim për implementimin e projektit “Përkrahja e integrimit të grave në zonat rurale”, ku jemi në process të themelimit të Qendrës për Angazhim të Komunitetit të Grave, një hap tutje drejt mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të grave në Komunën tonë;
- Në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, përgjatë gjithë kohës së organizimit të procesit të Regjistrimit të Popullsisë, kemi bashkëpunuar ngushtë dhe kemi ofruar mbështetjen tonë, si dhe kemi bërë informimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e regjistrimit të Popullsisë;

- Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me Organizatën OPFAKKOS kemi organizuar për herë të parë aktivitetet sportive me personat me nevoja të veçanta, në përpjekje që të angazhohemi në drejtësia të integrimit të kategorive të ndjeshme të shoqërisë;
- Kem vazhduar bashkëpunimin me KFOR-in dhe CIMIC-un Italian, ku këtë vit kemi pranuar si donacion disa kompjuterë dhe një printer multifunksional laserik për bibliotekat lokale në Dragash;
- Kemi realizuar një takim me Këshillin Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive, ku përfaqësues nga fusha e sportit në Komunën tonë janë informuar për infrastrukturën ligjore që rregullon fenomenin e dukurive negative në ngjarjet sportive;
- Me Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim kemi krijuar raporte të bashkëpunimit, me qëllim të vendosjes së bazave elementare për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në Komunën tonë;
- Me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas kemi pasur një sërë aktivitetesh për të reflektuar mbi rëndësinë e promovimit të të drejtave të grave dhe hartimit të politikave që synojnë përmirësimin e pozitës së grave në shoqërinë tonë;
- Si Qeverisje lokale, kemi mbajtur disa takime për të diskutuar mbi adresimin e kërkesave dhe vërejtjeve tona që duhet të përfshihen në procesin e hartimit të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Sharri”. Duke qenë të vetëdijshëm se gjendja aktuale me PK “Sharri” po na shkakton shumë vështirësi në shfrytëzimin e mundësive për investime të ndryshme në Komunën tonë, ne kemi adresuar disa kërkesa tek autoritetet kompetente, në mënyrë që të krijojen kushtet ligjore për investime dhe të bëhet ridefinimi i disa zonave të Parkut Kombëtar “Sharri”;
- Gjithashtu, Asambleja Komunale përmes një Vendimi e ka dhënë dritën e gjelbër për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, një dokument shumë i rëndësishëm i cili do të parashev një sërë objektivash për zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Dragashit brenda një periudhe tetëvjeçare;
- Në bashkëpunim me Shoqatën Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit”, kemi bërë shpërndarjen e 100 pakove ushqimore dhe 100 pakove higjenike për familjet në nevojë në Opojë dhe në Gorë, me rastin e festës së Fitër Bajramit;

- Përmes procedurave të Ankandit publik, kemi kryer të gjitha obligimet ligjore për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës – sipërfaqeve afariste apo lokaleve;
- Edhe këtë vit, në muajin prill kemi marr pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit dhe Sportit, së bashku me katër biznese lokale private nga sektori i hotelerisë dhe turizmit, me ç'rast kemi prezantuar vlerat e trashëgimisë kulturore, bukuritë natyrore, ushqimet tradicionale, si dhe kapacitetet e shërbimit hotelier e turistik që ofron Komuna jonë;
- Me Ministrinë e Infrastrukturës kemi nënshkruar Memorandum bashkëpunimi për financimin e projektit “Asfaltimi i rrugës Zlipotok-Baçkë-Brod”, në vlerë prej 350 mijë euro;
- Kemi hartuar Planin trevjeçar të Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës, një dokument i rëndësishëm i cili parashev aktivitete që do të ndikojnë në parandalimin e fenomenit të braktisjes apo mosregjistrimit të nxënësve në shkollë;
- Në maj të këtij viti kemi filluar Programin e vizitave sistematike shëndetësore të nxënësve nëpër shkolla;
- Me organizatën japoneze JICA, jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm për ecurinë e përgjithshme të reformës së sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Komunën tonë;
- Këtë vit, Komuna e Dragashit ka qenë nikoqire e organizmit të Debatit mbi politikat në kuadër të Javës së Gruas, e cila organizohet çdo vit nga Instituti Kombëtar Demokratik. Përfaqësues të shumtë nga komunat e Regionit të Prizrenit kanë marrë pjesë në këtë Debat, për të diskutuar për adresimin e çështjeve gjinore, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe politikat e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor në nivel lokal;
- Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, më 1 qershor të këtij viti, në bashkëpunim me organizatën “NEVO KONCEPTI” kemi themeluar Asamblenë e Fëmijëve, një platformë e cila do të shërbejë si një mundësi e mirë që zëri i fëmijëve të dëgjohet në të gjitha nivelet e vendimmarrjes;
- Me Vendim të Asamblesë Komunale, një delegacion i Komunës së Dragashit ka realizuar një vizitë studimore në Itali, me ç'rast është vizituar Komuna San Vito al Tagliamento, për t'u njoftuar me funksionimin politik-administrativ të kësaj komune italiane, si dhe për të shkëmbyer praktika dhe shembuj pozitivë të politikave të menaxhimit në nivel lokal;
- Jemi në proces të hartimit të Planit komunal të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku i kemi kaluar të gjitha fazat e konsultimit me qytetarët dhe presim që Asambleja Komunale ta miratojë këtë Plan në seancat e radhës;

- Gjithashtu, jemi në proces të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore;
- Gjatë kësaj periudhe gjashtëmuore të vitit 2024, kemi realizuar vizita dhe inspektimë të vazhdueshme nëpër të gjitha vendpunimet ku ka filluar puna në realizimin e projekteve, për të përcjellë nga afér mbarëvajtjen e tyre;
- Gjatë kësaj periudhe të raportimit, jemi duke vazhduar në realizimin e shumë projekteve dy dhe trevjeçare, si dhe në disa projekte të reja të cilat ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme në Komunën tonë. Këto projekte kryesisht lidhen me:
  - Asfaltimin dhe renovimin e rrugëve lokale brenda territorit të Komunës;
  - Ndërtimin e këndeve të lojërave dhe shtigjeve të ecjes;
  - Mirëmbajtja dhe rregullimi i oborreve të shkollave;
  - Kubëzimi i rrugëve lokale;
  - Rregullimin dhe mirëmbajtjen e terreneve sportive (stadiumeve);
  - Projektet që lidhen me sistemin e menaxhimit të mbeturinave;
  - Furnizimi i institucioneve të Administratës, Arsimit dhe Shëndetësisë me pajisjes të nevojshme për ecurinë normale të punës së institucioneve.

Unë në pikë të shkurtia i përmenda disa prej aktivitetave, nuk kam mund t'i përfshij të gjitha, por në Takimin e dytë njëvjeçar do t'i përfshijmë me emër e mbiemër të gjitha projektet. E kisha lut drejtoreshën e Kulturës që të dalë të bëjë një raportim të punës gjashtëmuore të DKRS-së.

**Liridona Misinaj, drejtoreshë e DKRS-së:** Përshendetje për të gjithë! I nderuar kryetar, i nderuar drejtor Qamil, të nderuar të pranishëm! Ne si Drejtori kemi zhvilluar aktivitete nga më të ndryshmet, kulturore, rimore dhe sportive. Duke filluar: Takim me të rinjtë e Komunës; Flakën e Janarit; 17 Shkurtin – Ditën e Pavarësisë; Epopeja e UÇK-së; Festivali “Hasi Jehon”; 5 Maji – Dita e Dëshmorëve të Atdheut; Trajnim për marketing në mediat sociale; 1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve (bashkë me OJQ “AVOKO” një program artistik); Eksposítë me fotografi; Sofra e Ymer Prizrenit; hartimi i Planit të Turizmit; Festivali Folklorik Mbarëkombëtar “Hani i Elezit”, me pjesëmarrës ShKA “Bresana”; Dita e Çlirimtës së Komunës sonë, edhe ky aktivitet i cili u krye ditët që lamë pas; Festivali Gjithëkombëtar i Folklorit “Është e Ndezur mbi Shkëlzen”, në Deçan, edhe këtu ka qenë pjesëmarrëse ShKA “Bresana”, ku edhe më duhet t'i përshëndes dhe t'i falënderoj sepse po korrin një sukses të

jashtëzakonshëm. Ndërsa, sa i përket financimit të OJQ-ve, kemi mbështetur ShKA “Bresana”, në vlerë prej 90 mijë euro për manifestimet e Komunës, vlerat kulturore dhe ruajtjen e folklorit; “Kroi i Maces” për Sofrën e Ymer Prizrenit, me 4 mijë euro; OJQ “Biser” për Ditët e Mërgatës, me 3500 euro; ShKA “Opoja” me 5500 euro; OJQ “MKAC Band” me 6 mijë euro. Në fushën e sportit: KF “Opoja” është mbështetur me 35 mijë euro; Shkolla e Futbollit “Aroma Sport” me 4500 dhe Shkolla e Futbollit “Dragash Sport” me 4500 po ashtu. Gjithashtu, Klubi i Kuajve “Opoja” me 9 mijë euro; Klubi i Shahut “Sharri” me 4 mijë; Klubi i Motoristëve “Enduro Sharri” me 5 mijë euro, dhe Demokratska Omladina Gora me 3 mijë euro; OJQ “Avoko” me 5 mijë euro. Këto janë aktivitetet dhe mbështetjet të cilat i ka bërë DKRS-ja, me mbështetje të Kryetarit Xheladini. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Në eksponenë e drejtoreshës u tha që ShKA “Bresana” nga Bresana është e vetmja shoqëri kulturore-artistike e Komunës sonë, e cila këtë vit ka korr katër suksese të mëdha. Në tri pjesëmarrje e ka marrë vendin e parë, ndërsa në Has e ka marrë vendin e dytë. Unë dua ta falënderoj ShKA “Bresana” për sukseset e arritura, sepse me pjesëmarrjet e tyre kanë paraqitur vlerat kulturore-artistike të trevës sonë. Unë e kam një apel: I inkurajoj qytetarët e komunitetit joshumicë që ta themelojnë edhe këta një ShKA, për arsy se kanë vlera të papara artistike dhe kulturore. Sigurisht që nëse formohet kjo ShKA në regionin e Gorës, do ta ketë mbështetjen e Komunës, ashtu siç e ka edhe ShKA “Bresana”. Është mirë – pasi këtu e kemi edhe RTK-në – të bëjë apel dhe t’i inkurajoj njerëzit e kulturës në regionin e Gorës, që ta themelojnë edhe këta një ShKA, e cila do t’i pasqyroj në të ardhmen, jo vetëm në nivel lokal, por edhe në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, vlerat kulturore të regionit të Gorës. Nëse do dikush me pyet lidhur me Raportin e punës së kryetarit, hapi debat për këtë çështje.

**Qamil Kolloni:** Fillimisht deshta ta përshëndes drejtoreshën e Kulturës për angazhimin, por t’i përshëndes edhe të gjitha OJQ-të të cilat kanë qenë të mbështetura kryesisht nga Qeveria lokale, nga Drejtoria e Kulturës, të gjitha atyre të cilat janë seriozisht duke u angazhuar. Në veçanti dua ta përshëndes ShKA “Bresana”, se këtë vit ka qenë shumë aktive, përpos që ka qenë aktive, ka dhënë edhe rezultate. Në disa vende kemi qenë përcjellës, ka qenë tepër impresionues. Dhe – për pak kryetari harroi – se në Han të Elezit ka marrë Çmimin e veçantë, që është për autenticitet të kulturës opojare. Dhe gjithashtu, kjo si shoqëri është duke ruajtur dhe kultivuar një kulturë që është vështirë dikush ta mbajë dhe ta avancojë. Prandaj, ne i përshëndesim dhe i falënderojmë. Gjithashtu, edhe dje kemi parë një garë shumë atraktive, vrapimin e kuajve. Por, edhe OJQ-të e tjera të cilat kanë bërë aktivitete, i përshëndesim dhe urojmë që edhe viteve të tjera të kemi një bashkëpunim të ndërsjellë me zyrtarët

komunalë në përgjithësi. Për Raportin gjashtëmujor të kryetarit ka shumë me thënë, se shpeshherë bëhet modest edhe nuk i promovon të gjitha këto, por me rëndësi është që kemi gjet një gjuhë të përbashkët dhe jemi në vijë të mirë, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile.

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit, drejtor! Vetëm desha t'ju informoj se edhe këtë vit do të vazhdojmë me Festivalin Ballkanik “Opoja Vallëzon”, i cili do të mbahet nga data 24, 25 dhe 26 korrik. Veçanti e këtij Festivali do të jetë se defileja do të bëhet me qen ilirë të Sharrit. Gjithashtu, për herë të parë do ta bëjmë edhe një ekspozitë të qenve ilirë të Sharrit, do të shpallim një thirrje publike, ku qeni më i mirë, vendi i parë dhe i dytë do të shpërblehet. Këtë traditë duhet ta vazhdojmë dhe nuk duhet të lejojmë që originën e qenit, deltarit ilir, të na grabis dikush tjetër, sepse qeni ilir i Sharrit është qen autokton i trevave tona. Andaj, nga sot - pasi këtu i kemi edhe mjetet e informimit – ata të cilët do të marrin pjesë në këtë garë, duhet të përgatiten në mënyrë që, më datën 24 të jenë aty me qentë e tyre ilirë. Dhe është një kërkësë e jona që, personat të cilët do të vijnë e t'i eksposojnë këta qenë, duhet të vishen me tesha kombëtare. Faleminderit.

**Ruzhdi Domuzeti, fshati Plajnik:** Një pyetje për drejtoreshën. Thatë që për Shkollën e Futbollit “Aroma”, 4500 euro keni dhënë. A mund të na sqaroni, ato mjete për çka përdoren, sepse krahas kësaj, unë paguaj edhe 20 euro për fëmijën tim.

**Liridona Misinaj:** Faleminderit për pyetjen! Sa i përket aktiviteteve të cilat i organizojnë shkollat e futbollit, ato bien raport finanziar në DKRS, me të cilin e dëshmojë dhe dokumentojnë aktivitetin e tyre dhe mjetet, të hollat, se ku shkojnë. Ato mjete i përdorin për aktivitetet të Klubit, për pjesëmarrje në stërvitje, angazhimet që i ka Shkolla e Futbollit. Nëse jeni të interesuar, mundeni me bo kërkësë për qasje në dokumente zyrtare, edhe mundesh me e pa direkt se ku shkojnë ato mjete financiare të cilat ju veç po i jepni për fëmijët. Pa problem!

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit! Nëse nuk ka pyetje tjera, e përfundojmë këtë takim! Ju falënderoj shumë për prezencën tuaj!

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-takimi-i-pare-publik-me-qytetare/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-u-sali-skupstine-opstine-odrzan-prvi-javni-sastanak-sa-gradjanima/>

**Në Facebook:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/pLTnP28toA5fsJyH/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1kP5NFcPfGhMCjPd/>

**SHTOJCË:** *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragaš**

02 Nr. Br. 060/01-11967/24  
18.06.2024



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E DRAGASHIT  
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Data/Datum: 18.06.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash / Sala Skupštine Opštine - Dragaš

**LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIMIN E PARË PUBLIK ME  
QYTETARË PËR PUNËN E KRYETARIT PËR GJASHTËMUJORIN E  
PARË TË VITIT 2024**

**LISTA UČESNIKA NA PRVI JAVNI ZKUP SA GRADANIMA  
ZA RAD PREDSEDNIKE U PRVIH ŠEST MJESECI 2024. GODINE**

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivališe	Etnia Etnička pripadnost	M	F	Nënskrimi Potpis
				M	Ž	
1	DREMË Myrtezën	Zgjilxhi	Kosovar	✓		
2	LIRIDONA MISINAJ	PITAVE	KOSOVARE	✓		
3	Kaltrina Gashi	Brenze	Kosovare	✓		
4	ULIMOËC DZOCBIA	BELIC	Kosovare	✓		
5	NINETE BEKISHA BUGO	BUGO	KOSOVARE	✓		
6	Bronislav Ranković	BUGO	Kosovar	✓		
7	Veton Bajraktari	Bellabrod	Kosovar	✓		
8	Faton Vojeri	KUK	Kosovar	✓		
9	Ajmu Kochaku	Bellabrod	Kosovar	✓		
10	JARDIAN HALILI	BEPUT	Kosova	✓		
11	Isa Bajrami	Shajne	Kosovar	✓		
12	Besim Hadriçan	BESID	Bosniak	✓		
13	Nerhija Tairrović	Zlipotok	Bosniak			
14	Fikim SOAHIĆ	DRAGASH	SHKODRAN	✓		
15	SABAHAT AŞAŞI	ZGATAR	SHKODRAN	✓		
16	Emrah Pinoj	PLAV	SLIVIĆ	✓		
17	FLORIM KRASNIĆ	BRGËS	SHKODRAN	✓		
18	Veton Halili	ZAPLUXHE	SHKODRAN	✓		
19	LZULBEHAR TAIFI	LESTANE	BOSNJAK	✓		
20	Munir Jonuzi	Rajča	Bosnjak	✓		
21	LEDJIL DEDSHI	BESCAN	SHKODRAN	✓		
22	Zvad Lepraj	Plavë	SHKODRAN	✓		
23	Dardan Bajrami	Dragash	SHKODRAN	✓		
24	Envi Selimi	teraz	SHKODRAN	✓		

25	PERCY FATIĆ	Blac	Shqiptar	V		Balk - Gjet
26	FARI Kozlom	Kosovar	Shqiptar	V		
27	Ruzai Domuzeti'	Pecajlic	Shqiptare	M		Zuslovi - Dauti
28	Vallnet Dauti'	Nenxe	Shqiptari	M		Dauti
29	SUAD TOSUNIĆ	Rapea	BashkiaK	m		Tosun
30	Adeun Emini	Zgater	Shqiptar	m		Zgater
31						
32						
33						
34						
35						
36						
37						
38						
39						
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						

W



